

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 19-të e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 18.10. 2023

Në mbledhje morën pjesë:

- 1.Mirheta Gaçeviq, kryetare;
2. Veron Halili, anëtar;
- 3.Admir Adroviq, anëtar;
- 4.Ivana Krushçiq, anëtare;
5. Frashër Selimaj, anëtar;
- 6.Tripo Matijeвиq, anëtar

Krahas anëtarëve të cekur të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe Ballsha Miliq, sekretar i Komisionit. Gjithashtu, me ftesën e kryetares së Komisionit dhe anëtarëve tjerë, në mbledhje morën pjesë edhe Redaktorët e Redaksive në gjuhën shqipe në TVMZ dhe RMZ, Nik Kalaj dhe Marash Dedvukaj.

Në mbledhje u miratua

### RENDI I DITËS

1. Diskutim dhe deklaram lidhur me Procesverbalin nga mbledhja e tetëmbëdhjetë e rregullt e Komisionit;
2. Bisedë me përfaqësuesit e Redaksive për pakica në gjuhën shqipe;
3. Analiza dhe komentet në informatën e dorëzuar nga ana e redaktorëve të Redaksisë gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale;
4. Të ndryshme

#### I

Procesverbali nga mbledhja e tetëmbëdhjetë e rregullt e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, me disa vërejtje në pjesët e të cilit do të përmirësohet. (6 vota PËR)

#### II

Kryetarja e Komisionit, Mirheta Gaçeviq, deklaroi se në mbledhjen e sotme nuk kanë të pranishëm redaktorin e Programit për pakicat, Senad Gilaj, i cili për shkak të angazhimeve të tij të mëparshme gjendet jashtë territorit të Podgoricës, dhe nuk ka mundur të marrë pjesë dhe në mungesë të tij, ai delegoi redaktorët e Redaksive në gjuhën shqipe të TVMZ dhe RMZ, Nik Kalaj dhe Marash Dedvukaj. Që në fillim të bisedës ajo i pyeti redaktorët e pranishëm të Redaksisë nëse janë të njoftuar me emisionin “Mramori znamenitih Crnogoraca- Mermeret e Malazezëve të Famshëm” që ishte planifikuar të xhirohej dhe nëse mund t’i tregonin diçka më shumë për të, për të cilën ata u përgjigj se nuk ishte temë për ta. Më pas ajo shprehu dëshirën që ajo dhe anëtarët e pranishëm të Komisionit të bisedojnë për vetë kushtet dhe mënyrën e funksionimit të Redaksive, ndryshimet në këto Redaksi, për të cilat asnjëri prej tyre nuk ishte i informuar, për ndryshimet në Plani i PP si dhe problemet dhe

barrierat e tjera me të cilat ballafaqohet vetë Redaksia, dhe ftoi redaktorët e pranishëm të paraqesin mendimet, vërejtjet dhe idetë e tyre për punën e Redaksive.

I pari që mori fjalën ishte Marash Dedvukaj, Redaktor i redaksisë në gjuhën shqipe në Radio Mali i Zi. Ai që në fillim theksoi problemin kryesor që mendon se ekziston, duke thënë se që nga muaji shkurt ishin pritur të ndodhin ndryshimet në redaksi, duke pasur parasysh se redaktori i atëhershëm i redaksisë, Pjetër Lucaj, doli në pension dhe kjo pozitë sipas sistematizimit mbeti bosh dhe dikush duhej ta zëvendësonte. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur deri më sot. Po ashtu edhe një kolege tjetër pas 3 muajsh del në pension, është Gjekë Gjonaj, bashkëpunëtori nga Ulqini, dhe pyetja është nëse do ta zëvendësojë dikush. Problemin ia ka paraqitur menaxhmentit, ku ka marrë përgjigjen se sido të jetë në redaksi do të ishin 6 apo 7 të punësuar. Ai u përpoq t'u shpjegonte atyre se nuk janë aq, por gjithsejtë "3 e gjysmë" persona - punëtorë, me shpjegimin se janë 3 veta, dhe se kjo "gjysma" ose " e gjysë" i referohet spikeres- daktilografes që është e sëmurë dhe se nuk ka mundësi për të qenë punonjësi i katërt në Redaksi. Ai theksoi se edhe më parë, kur ishin vërtet 7 punëtorë, kërkonte një shtesë, jo tani kur ishin vetëm 3 ose 4. Gjithashtu, tani këtu është një nga gazetarët që është në pushim mjekësor 7-8 muaj dhe atë nuk e zëvendëson kush. Siç thotë ai, përse i përket atij nuk e shqetëson kjo se ai duhet të pushojë, por duhet të bihet dikush që do të mund të marrë përsipër pjesën e tij të punës. Ai thotë se që nga muaji shkurt, që nga momenti kur Pjetër Lucaj doli në pension, ka insistuar për të sjellë zëvendësuesin e tij, gjithmonë ka marrë përgjigjen "do të jetë, do të jetë", por asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim dhe nuk ka ndodhur asgjë dhe nuk e sheh se ku është problemi që nuk është realizuar as sot e kësaj dite. Gjithashtu, ai shprehet se nuk kërkojnë hapjen e një vendi të ri pune, por vetëm plotësimin e atyre ekzistueseve.

Mirheta Gaçeвиq lidhur me këtë e pyeti se që nga shkurti, nga 7 persona në redaksi, në sa kanë mbetur tani?

Marashi ka përmendur personat që ndodhen aktualisht në këtë redaksi, ai vetë, Musa Gjoka, Violeta Gjokaj, pastaj spikerja-daktilografe e cila është e sëmurë, prandaj thotë se ajo është "gjysmë" punëtoare, si dhe punëtoarja e re që duhet angazhuar me kohë të pjesshme. Ai përsëri përmendi problemin e daljes në pushim mjekësor, si pasojë e të cilit po humbet numri i punëtorëve në Redaksinë dhe komentoi se problemi sipas tij është që të sëmurët punojnë këtu, kurse të shëndoshët vazhdojnë pushim mjekësor për të pushuar në shtëpi. Ai shprehet se mungesa e dikujt ndjehet menjëherë, është ndërherë më herët kur dikush ka shkuar me pushime, e jo tani kur dikush nuk është më dhe vendet janë të lira, sepse për disa emisione duhet kërkuar ndihmë nga kolegët e TVMZ. Kur Senadi ishte me ta për herë të fundit në Redaksi, i tha se nuk do të luftojë më për këtë Radio sepse ai nuk është i Marash Dedvukajt, por Radio Televizioni i Malit të Zi. Ai gjithashtu përmend se në trajnim ka sjellë një kandidate të re e cila sapo ka përfunduar trajnimin është transferuar në Televizion. Ai theksoi se i ka thënë Senadit se tani e tutje do të punojë me aq sa mundet dhe më e vështira për të është se si redaktor i redaksisë duhet të bëjë punën e gazetarit, nëse jo edhe më shumë se ata. I vetmi ndryshim mes tyre është se ai ka titullin Redaktor, asgjë tjetër. Ai po ashtu ka deklaruar se së shpejti duhet të fillojë të transmetohet emisioni " Pa Kufi" i cili ka 12 vjet që transmetohet në Radio Prishtinë, në Radio Shkup dhe në Radio Tiranë dhe së shpejti do të fillojë të transmetohet në Radion tonë dhe sërish nuk ka kush të punojë përveç tij. Edhe një herë ai theksoi dhe përsëriti se nuk kërkon ndonjë punëtor të ri, vetëm të plotësohen ato ekzistueset.

Në përgjigje të gjithë kësaj, Mirheta Gaçeвиq theksoi se mundësia e Komisionit, në përputhje me Rregulloren e punës, është që Këshillit të RTMZ-së t'i japë iniciativa dhe mendime në lidhje me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në RTMZ. Ajo deklaroi se do të marrë përsipër personalisht nismën, e cila do të synojë t'i japë asaj informacion të saktë se sa vende pune me sistematizim parashihen në Redaksi. Gjithashtu, ajo deklaroi se mendon se duhet të ketë njëfarë zgjidhjeje me problemin e pushimit mjekësor, se si duhet të bëhet zëvendësimi dhe se duhet të rregullohet me diçka. Më pas ajo pyeti redaktorët e redaksive në TVMZ dhe RMZ nëse do të ishte problem për ta që t'i dërgonin informacionet e saj me e-mail, në të cilin ata do të jepnin informacione specifike në lidhje me vetë redaksinë dhe ndryshimet në strukturën e kadrovike, dhe kërkoi që kjo të

jetë praktika e tyre tani e tutje. Ajo tha se sipas saj gjendja në Redaksinë për pakica në gjuhën rome është katastrofike dhe nuk është më mirë as në redaksinë e tjera, të cilat përgjithësisht kanë vetëm një gazetar.

Marash Dedvukaj tha se nuk ka probleme me njoftimet me postë elektronike dhe theksoi se asnjëherë nuk pyeten nëse mungon diçka në redaksi, por vetëm se duhet të realizohet një emision i caktuar.

Mirheta Gaçeвиq theksoi se asgjë nuk mund të realizohet pa punëtorë dhe teknologji, ndërsa teknologjia është zgjidhur dhe problemi i punëtorëve ende mbetet.

Marash Dedvukaj theksoi se menaxhmenti ka dashur ta hapë radio “24h online” dhe se nuk ka lejuar hapjen e tij dhe i ka thënë Senad Gilaj se në fakt nuk është kundër, se është për, por me kusht që të sjellin 3-4 gazetarë të rinj dhe ai mund të jetë nga ata që do të punojë dhe do të japë kontributin e tij, por jo i vetmi që do të punojë.

Mirheta Gaçeвиq tha se mezi është e mundur të bëhet puna ekzistuese, e jo e re, në mungesë të stafit, veçanërisht duke theksuar se e gjithë kjo është modeste dhe nën çdo nivel për një servis publik, që nuk ka asnjë gazetar që do të mbulojë ngjarjet ditore brenda një redaksie.

Admir Adroviq e pyeti Marash Dedvukajn për Pjetër Lucajn, se cila ishte pozita e tij në Redaksi, gjegjësisht pozita që mbulonte dhe a ishte redaktor për pakicat në Radio Mali i Zi, për ç'gjë iu përgjigj pozitivisht. Më pas ai pyeti për një gazetar tjetër, të cilit i thanë se ishte Gjoka Dukaj, i cili ishte në pushim mjekësor. Ai gjithashtu pyeti nëse ishte korrespondenti nga Ulqini, për ç'gjë Marashi u përgjigj se nuk ishte ai, por korrespondenti nga Ulqini duhet të pensionohet pas 3 muajsh.

Mirheta Gaçeвиq tha se është shumë e rëndësishme që të gjitha këto t'i cekin në emailin që kanë rënë dakord t'i dërgojnë.

Ivana Krushçiq pyeti për vajzën e re që ishte në redaksi dhe kishte përfunduar trajnimin, për të cilën Marash Dedvukaj u përgjigj se fjala është për Paula Dekaj për të cilën tha se pas trajnimit është dashtë të mbetet tek ta se bëhët fjalë për punëtorë të mirë, dhe u ka dërguar propozimin Burimeve njerëzore, por deri më sot ajo nuk ka marrë kontratë pune.

Në këtë bisedë është kyçur redaktori i redaksisë në gjuhën shqipe në TVMZ, Nik Kalaj, i cili tha se është folur se me sistematizimin e ri, Senad Gilaj do të jetë koordinator i të dy redaksive, si për pakicat në Radio ashtu edhe në Televizioni. Mirëpo, Senadi mori vendin e Redaktorit të pakicave në TVMZ, në një farë mase ai e bën edhe koordinimin me Radio, por me kalimin e kohës kjo humbi. Ai deklaroi se redaktorët tjerë të programit punojnë keq dhe se nuk ka ndihmë prej tyre, si dhe nuk është e drejtë që redaktorët e redaksive të punojnë gjithë ditën, të punojnë në Lajme e të ngjashme, sepse në fakt nuk e bëjnë punën e tyre kryesore dhe se duhet të dihet se çfarë është Redaktori. Rëndësi ka që ai bashkë me një koleg tjetër të përgatisin emisionin, “Lajmet”, dhe meqë ai kolegu tani është në pushim mjekësor, ai vetë e përgatit emisionin e përmendur dhe se nuk është e drejtë që 6 ditë në javë ta punojë vetë.

Admir Adroviq theksoi se nga gjithë kjo që kanë dëgjuar është se vëren se pozita e Redaksisë për pakica është shumë e dëmtuar dhe se në siç duket, shërben për të ndëshkuar disa gazetarë, pra për t'i degraduar ata. Kur nuk dinë ku ta vendosin një gazetar, e angazhojnë brenda kësaj redaksie. Ai beson se duhet inicuar nismën drejtuar Këshillave të tyre nacionale, sepse ata vetë realisht nuk mund të arrijnë asgjë.

Tripo Matijeвиq, iu bashkua bisedës i cili deklaroi se punon në një sistem bankar me mbi 200 të punësuar dhe se nuk mund të ndodhë që pas dorëheqjes së dikujt, pushimit mjekësor afatgjatë ose pensionimit të një punonjësi, pozitë të jetë e lirë më shumë se 30 ditë.

Admir Adroviq deklaroi se duhet gjetur zëvendësimi për punonjësin që largohet, pavarësisht nëse ai është në pension, në pushim mjekësor apo ngjashëm, veçanërisht nëse vendi i punës është sipas sistematizimit, sepse askush nuk do të pranojë të bëjë punën e dikujt tjetër dhe punën shtesë për të njëjtat të holla, duke u shprehur se ai do të ishte i pari që nuk do ta pranonte. Ai deklaroi se nga çdo mbledhje që vazhdon, qëndrimi dhe mendimi i tij është i tillë që e gjithë Redaksia për pakica është në një gjendje gjithnjë e më të keqe se më parë dhe se diçka duhet bërë urgjentisht sepse nuk mund të vazhdojë më kështu, sepse nëse ata, Komisioni, nuk mund të ndikojë në Këshillin e RTMZ-së, ata

mund të ndikojnë drejtpërdrejt në RTMZ përmes Këshillave të tyre nacionale. Për ironi, ai deklaroi se më së miri do të ishte të hiqet Redaksia për pakica.

Tripo Matijeviq tha se pajtohet me atë që u tha më parë dhe se beson se rruga më e mirë që duhet të bëjnë është që fillimisht ti drejtohen me iniciativë Këshillit të RTMZ-së lidhur me problemet që kanë evidentuar gjatë kësaj bisede, dhe u shpreh se beson se nuk do të të marrë një përgjigje të kënaqshme, e më pas, pa pritur përgjigjen e Këshillit të RTMZ-së, këtë t'ua paraqesin së bashku të gjitha Këshillave Kombëtare, dhe në mënyrë të koordinuar, duhet t'i dërgojnë 6-7 letra Këshillit dhe menaxhmentit të RTMZ-së dhe që të gjitha ato duhet të dërgohen brenda pak ditësh, duke qenë se kjo është mënyra e vetme për t'i bërë të ngacmuar sadopak për këto çështje.

Frashër Selimaj e vazhdoi bisedën, duke u shprehur se mendon se tashmë të gjithë e dinë se ku është problemi kryesorë dhe mbështeti propozimin për dorëzimin e Iniciativës ndaj të gjitha Këshillave nacionale.

Mirheta Gaçeвиq deklaroi se pajtohet me të gjitha ato që u thanë, si dhe me sugjerimet dhe konstatimet e anëtarëve të tjerë të Komisionit, por iu referua edhe asaj që i ra në sy, përkatësisht Raportit të Programit për pakica të nënshkruar nga Senad Gilaj, në të cilin flet për arsyet objektive pse nuk u realizuan shumë gjëra, por askund nuk thekson se e ka iniciuar dhe bartur përgjegjësinë tek menaxhmenti i RTMZ-së, se në të vërtetë ata janë përgjegjës për situatën aktuale në Redaksi, e jo vetëm redaktorët e Redaksisë.

Nik Kalaj u shpreh se beson se problemi nuk është vetëm te mungesa e kuadrit. Ata planifikonin të hapnin një studio në Ulqin, ku ka një popullsi me shumicë shqiptare në Mal të Zi. Ata i janë drejtuar kryetarit të komunës së Ulqinit për sigurimin e hapësirës për atë studio, por ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje pozitive nga ai. Me këtë ide u pajtua edhe drejtori i RTMZ-së dhe u tha se përveç korrespondentit tashmë ekzistues nga Ulqini, do të punësojë edhe një tjetër. Gjithashtu atje kanë një kameraman dhe studioja do të mund të vihej në funksion. Gjithashtu, siç shprehet ai, ata kanë nevojë për një korrespondent tjetër nga Plava.

Mirheta Gaçeвиq për bisedën në fjalë tha se në fakt këto janë arsyet kryesore dhe jo ato të shënuara në Raportin e nënshkruar nga Senad Gilaj.

Nik Kalaj më pas deklaroi se arsyet e vërteta janë se ata nuk kanë studio në Ulqin dhe nuk kanë korrespondent nga Plava që do të përgatiste raporte dhe inçizime, por jo me çmimin prej 10 euro siç ishte propozuar. Ai gjithashtu ceku se kanë fituar kamerë donacion nga SHBA, por nuk kanë kameraman. Ka pasur tentativa për gjetjen e një kameramani, por pa rezultat, ndoshta sepse ishte propozuar që kameramani të merrte një honorar prej vetëm 300 euro.

Mirheta Gaçeвиq më pas i pyeti redaktorët e pranishëm nëse ata marrin pjesë në hartimin e propozim planit të Programor dhe të Produksionit (PP planit), për të cilën ata u përgjigjën negativisht.

Redaktorët e Redaksisë në gjuhën shqipe deklaruan se plani i fundit i PP-së është bërë sipas parimit “copy- paste” bazuar në atë që i ka paraprirë.

Nik Kalaj më pas tha se është planifikuar emision i ri “Fokus”, i cili duhet të fillojë të transmetohet nga muaji dhjetor, i cili do të ishte një emision pak më përmbajtësor, në të cilin do të punoheshin reportazhe dhe biseda me peshë më të madhe. Këtë ide e ka përkrahur edhe drejtoresha e TVMZ, Marija Tomašević.

Marash Dedvukaj ka thënë se ka pasur një propozim konkret për drejtorin në lidhje me rindarjen brenda vetë Redaksisë, por në fund nuk ka dalë asgjë. Ai deklaroi se është më mirë të mbyllet vetë Redaksia, se sa të punohet siç funksionon aktualisht.

Mirheta Gaçeвиq deklaroi se do të bëjnë gjithçka që munden sa i takon Komisionit, por ajo personalisht nuk është shumë optimiste për këtë çështje. Ajo tha gjithashtu se do të kërkojë zyrtarisht sistematizimin e vendeve të punës në Redaksinë e pakicave në Radiotelevizion, si dhe nga redaktorët e redaksisë që t'u japin informata e kërkuara për çgjë ishin dakorduar.

Tripo Matijeвиq për këtë tha se duhet të kërkojen informata se cilat vende sipas sistematizimit janë të lira në Redaksi dhe që kur janë të lira, përkatësisht në cilat pozita të punësuarit nuk janë në punë për

shkak të sëmundjeve apo ndonjë arsye të ngjashme, në mënyrë që ta kenë situatën e qart, të bardhën në të zezën, dhe nëse marrin informata kontradiktore, të mund të reagojnë në përputhje me rrethanat. Admir Adroviq tha se nuk kanë informatë madje as kush punon në redaksi të Programit për pakica. Kryetarja e Komisionit, Mirheta Gaçeviq, i falënderoi redaktorët e Redaksisë për pjesëmarrjen në mbledhjen e sotme dhe tha se shpreson se do të rezultojë diçka nga biseda e sotme.

### III

Në kuadër të pikës III është diskutuar në lidhje me “Analizën dhe komentet mbi informacionin e dhëna nga redaksia në gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale”, pra nga vetë redaktori i Redaksisë, Bogiq Rakoçeviq.

Ivana Krushçiq deklaroi se nuk e kishte të qartë pozitën e punëtorëve brenda Redaksisë, kështu që anëtarët e tjerë u përfshinë dhe i shpjeguan ndryshimet që kanë ndodhë atje.

Mirheta Gaçeviq tha se në atë redaksi, sipas sistematizimit, kanë redaktorin e Redaksisë, ky është Bogiq Rakoçeviqin dhe redaktoren e emisionit, Sllavica Krushçiq- Vasoviq dhe se në atë redaksi mungon gazetari. Në pyetjen e Ivanës nëse Sllavica Krushçiq- Vasoviq është në të vërtetë gazetarë, Mirheta Gaçeviq sqaroi se nuk është për shkak se ajo refuzon të merret me punë gazetareske, në kuptimin e ndjekjes së ngjarjeve të përditshme të çfarëdo lloji, daljes në terren dhe të ngjashme.

Ivana Krushçiq tha se e mbështet në këtë, duke u shprehur se një gjë e tillë nuk i shkon për shtat një gruaje me 30 vite përvojë pune dhe në moshën e saj.

Mirheta Gaçeviq deklaroi se nuk e ka të qartë pse Bogiq Rakoçeviq në informatën e dorëzuar deklaroi se e kishin të pamundur të bënin punë në terren në moshën e tyre, që kishte fjalën për dy gazetarët që u larguan nga Redaksia për pakica dhe ndërkohë Sllavica Krushçiq iu bashkua Redaksisë, e cila po ashtu është një grua në vite dhe paralajmëroi se do të bisedojë me të për këtë.

Më pas Ivana pyeti, nëse e kuptoi mirë, se aktualisht në atë redaksi janë vetëm Sllavica Krushçiq- Vasoviq dhe Bogiq Rakoçeviq, të cilës iu shpjegua se Sllavica në të vërtetë është e vetmja që punon dhe se Bogiq Rakoçeviq është redaktori i Redaksisë dhe se ai i vjen ndonjëherë në ndihmë, për çgjë Ivana tha se situata në këtë Redaksi është më urgjente se çdo gjë tjetër sepse është e papranueshme që një person të jetë spiker, gazetarë dhe redaktore e emisionit.

Admir Adroviq deklaroi se Sllavica Krushçiq- Vasoviq ishte për 3 vjet e pacaktuar në ndonjë vend dhe tha se menaxhmenti i RTMZ nuk mund të silltet në atë mënyrë që Redaksinë për pakica ta perceptojë si vrimën e fundit dhe ta degradojë aq shumë.

Më pas, të gjithë anëtarët e Komisionit ranë dakord se nevojiten një sërë iniciativash që do të shkojnë në Këshillin e RTMZ-së dhe përpiluan një listë që do të dorëzohet Këshillit në mbledhjen e parë të ardhshme. Po ashtu, Mirheta Gaçeviq ka pasur një pyetje të gatshme për redaktorin e Redaksisë për Programin e pakicave, Senad Gilaj, se cila është arsyeja që nuk është realizuar emisioni, "Glasovi iz susjedstva- Zërat nga fqinjësia", duke thënë se edhe të tjerët kanë mbetur pa përgjigje për këtë pyetje si në mbledhjen e fundit ashtu edhe në këtë mbledhje.

Mirheta Gaçeviq më pas i kërkoi nga anëtari i Komisionit Frashër Selimaj që të kërkojë informatë nga Redaksia në gjuhën shqipe dhe t'ia dorëzojë asaj në mënyrë që të kenë një pasqyrë më të plotë për gjithçka, me të cilën ai u pajtua dhe deklaroi se do ta bëjë këtë.

Admir Adroviq deklaroi se është për dërgimin e një iniciative në Këshillin e RTMZ-së, e cila do të referohet nëse ka mundësi që menaxhmenti apo redaktorët e TV-së të përsërisin emisione dokumentare në kuadër të programit për pakica dhe t'i referohet mungesës së përmbajtjes të programit. Nëse nuk është e mundur të reprizohen, t'i vendosin ato në PP planin për vitin e ardhshëm.

### IV

Në pikën e rendit të ditës, "Të ndryshme", kryetarja e Komisionit, Mirheta Gaçeviq, pyeti sekretarin e Komisionit nëse, përveç kërkesës zyrtare në Këshillin e RTMZ-së, mund t'i dërgohet plotësim i Kontratës në Marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve publike për periudhën Janar 2018 - Dhjetor 2020, që ka të bëjë me propozimin e Programit detyrues që është pjesë përbërëse e vetë Marrëveshjes, të cilës i është përgjigjur se për këtë çështje mund ti drejtohet Këshillit me Iniciativë.

PROCESVERBALIN E PUNOI  
Ballsha Miliq

KRYETARJA E KOMISIONIT  
Mirheta Gaçeviq